

VENDIM
Nr. 771, datë 20.12.2017

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. YLLKA MUJI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Yllka Muji, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi